## AKTI I THEMELIMIT
## I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR «ETEM»SH.P.K.

Ne Gjirokaster sot me daten 15.02.2000 une ortaku i vetem:
Hetem Cako i biri i Dervishit, i Dl.1968, banues ne Kordhoce, Gjirokaster vendosa qe te themeloje shoqerine me pergjegjesi te kufizuar sipas ligjit Nr.7638 date 19.11.192 «Per shoqerite tregetare» dhe ligjit Nr.7667 date 28.1.1993 «Per regjistrin tregetar...»duke perpiluar kete Akt themelimi me permbajtje si me poshte:

NENI 1

Te themeloje shoqerine me pergjegjesi te kufizuar me emertimin «ETEM»SH.P.K. te ortakut te vetem Hetem Cako .

NENI 2

Selia e shoqerise eshte Kordhoce, Gjirokaster.Shoqeria mund te hapi dege ose filjale edhe ne vende te tjera te Republikes se Shqiperise.

NENI 3

Afati i veprimtarise se shoqerise do te jete 15 vjete.
Shoqeria per cdo shkak dhe ne cdo kohe mund te zgjasi ose ta shkurtoje kete afat me vendim te Asamblese se ortakeve.

NENI 4

Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete:
Tregeti e pergjitheshme import-export; perpunim e tregetim i lendeve drusore; amballazhim e tregetim me pakice te vajrave lubrifikante.

NENI 5

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 leke.Ky kapital ndahet ne 100 pjese, vlera nominale e cdo pjese eshte 1000 leke. Ky kapital eshte derdhur i teri nga ortaku i vetem Hetem Cako .

NENI 6

Organi me i larte i shoqerise eshte Asambleja e ortakeve.
Kompetencat e saj percaktohen ne Statutin e shoqerise.Ne kete shoqeri me ortak te vetem kompetencat e Asamblese i ushtron ortaku i vetem.

NENI 7

Administratori i shoqerise eshte caktuar Hetem Cako , i biri i Dervishit i Dl.1968, lindur e banues ne Kordhoce, Gjirokaster.

NENI 8

Per arritjen e qellimit te saj shoqeria ka te drejte qe te punesoje edhe punonjes te tjere ne shoqeri me te cilet do te lidhi kontrata te vecanta pune sipas legjislacionit te punes ne fuqi.

NENI 9

Veprimtaria ekonomike-financiare e shoqerise do te mbyllet me daten 31 Djetor te cdo viti.

NENI 10

Shoqeia mbaron me vendim te Asamblese se ortakeve ose te ortakut te vetem per rastn konkret, ose me ligj. Me mbarimin e saj shoqeria vihet ne likujdim.Gjate likujdimit shoqeria ruan emertimin e saj duke shtuar fjalet «Ne likujdim».

NENI 11

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin gjate aktivitetit te shoqerise ne pamundesi te zgjidhjes se tyre me pajtim palet mund t`i drejtohen gjykates shqiptare sipas legjislacionit shqiptar.

ORTAKU THEMELUES
HETEM CAKO

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE, GJIROKASTER Nr.372 Rep.

VERTETIM

Ne Gjirokaster sot me daten 11.02.2000, para meje noteres Greta Kallojeri u paraqit personalisht i quajturi Hetem Cako , i biri i Dervishit , i Dl.1968, banues ne Kordhoce, Gjirokaster, i cili deklaroi me vullnetin e tij te lire se nenshkrimi ne kete Akt Themelimi eshte i tij dhe shprehje e lire e vullnetit te tij.

DHOMA E NOTEREVE
GJIROKASTER
NOT. GRETA KALLOJERI
TEL. 2278

## S T A T U T I
## I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR «ETEM»SH.P.K.

NENI 1

Themelohet shoqeria me pergjegjesi te kufizuar me emertimin «ETEM»SH.P.K. me ortak te vetem Hetem Cako i biri i Dervishit i Dl.1968, banues ne Kordhoce, Gjirokaster.

NENI 2

Shoqeria eshte person juridik privat dhe e ushtron veprimtarine e saj ne perputhje me Aktin e Themelimit te Statutit te shoqerise dhe legjislacionit shqiptar ne fuqi.

NENI 3

Selia e shoqerise eshte Kordhoce, Gjirokaster.
Shoqeria mund te hapi edhe dege ose filjale te tjera ne te gjithe teritorin e Republikes se Shqiperise si dhe me miratim te organeve kompetente edhe jashte Shqiperise.

NENI 4

Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise eshte 15 vjete.
Shoqeria ne cdo kohe dhe per cdo shkaku mund te shperndahet me vendim te Asamblese se ortakeve si dhe mund te zgjase afatin e veprimtarise se saj po me vendim te Asamblese se ortakeve.

NENI 5

Objekti dhe qellimi i veprimtarise se shoqerise eshte:
Tregeti e pergjitheshme import-export; perpunim e tregetim i lendeve drusore; amballazhim e tregetim me pakice te vajrave lubrifikante.

NENI 6

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 (njeqind mije) leke.
Ky kapital eshte derdhur i teri nga ortaku i vetem Hetem Cako .
Ky kapital ndahet ne pjese secila me vlere 1000 leke.

NENI 7

Kapitali mund te shtohet me vendim te ortakut te vetem i cili ka te gjitha kompetencat e Asamblese se shoqerise sipas ligjit.
Cdo ndryshim do te pasqyrohet ne librin e shoqerise ku shenohet kontributi per kapitalin e shoqerise per secilin ortak.

NENI 8

Pjeset e kapitalit te shoqerise jane lirisht te transferueshme.
Per transferimin e midis ortakeve te rinj qe mund te futen ne shoqeri behet me miratim te ortakut te vetem.

Ne rast transferimi te pjeseve te kapitalit ose te nje pjese te tij tek nje person i trete akti i transferimit ose i shitjes behet me akt noterjal.

NENI 9

Per ortaket e shoqerise mbahet nje liber i vecante ne te cilen shenohen emrat e ortakeve, shtetesia e tyre, adresa e selise ose e banimit te tyre, kontributi, pjeset ne kapitalin themeltar etj. Cdo ndryshim i personit ortak ose te kontributit ne shoqeri pasqyrohet ne librin e shoqerise.
Kundrejt shoqerise konsiderohet ortak dhe mund te ushtroje te drejtat e tij sipas ligjit e ketij Statuti vetem ai qe pasqyrohet dhe perfshihet ne librin e ortakeve.

NENI 10

Organi me i larte i shoqerise eshte Asambleja e ortakeve. Asambleja e ortakeve perfaqeson bashkesine e ortakeve dhe ka te drejte te vendosi per ceshtjet e meposhteme:
a)Ndryshimin e Statutit
b)Caktimi dhe shkarkimi i administratoreve
c)Futjen ne shoqeri te ortakeve te rinj.
d)Miratim i bilancit dhe ndarja e fitimeve
dh)Cdo ceshtje tjeter qe me ligj hyn ne kompetencen e saj eksluzive.
Ne kete shoqeri me ortak te vetem kompetencat e Asamblese i ka ortaku i vetem.

NENI 11

Asambleja e zakonshme mblidhet dy here ne vit.Detyrimisht Asambleja duhet te mblidhet ne tremujorin e pare te vitit per miratimin e bilancit.
Njoftimi per mbledhjen e Asamblese behet me shkrim nga administratori duke e bere kete njoftim jo me pak se 10 dite nga mbledhja e Asamblese.

NENI 12

Vendimet e Asamblese miren me shumice votash te ortakeve qe marin pjese ne mbledhje.
Cdo pjese perben te drejten e nje vote.

NENI 13

Shoqeria drejtohet nga nje administrator i cili emerohet nga Asambleja e ortakeve ose nga ortaku i vetem per kete shoqeri me nje ortak.
Administrator i shoqerise eshte caktuar Hetem Cako, i biri i Dervishit, Dl. 1968 banues ne Kordhoce, Gjirokaster.

NENI 14

Administratori i shoqerise kryen te gjitha veprimet e nevojshme ne interes te shoqerise. Ai perfaqeson shoqerine ne te gjitha organet shteterore dhe private.

NENI 15

Veprimtaria ekonomike financiare e shoqerise mbyllet me daten 31 te cdo muaji Dhjetor te vitit. Mbrenda tre muajve nxirret bilanci i shoqerise i cili analizohet nga asambleja e ortakeve ose ortaku i vetem.
Fitimi i shoqerise ndahet ne raport me perqindjen e kontributit ne kapitalin e shoqerise.

NENI 16

Ne rast shperndarjeje te shoqerise ose prishjeje te saj caktohen likujdatoret. Ata kryejne te gjitha veprimet per likujdimin e shoqerise sipas kerkesave ligjore.
Shoqeria kur eshte ne likujdim respekton emertimin e saj ne te cilen shtohen fjalet «ne likujdim»

NENI 17

Ne rast mosmarreveshjeje kur ato nuk mund te zgjidhen me mirekuptim do te zgjidhen nga gjykatat shqiptare sipas legjislacionit shqiptar

ORTAKU THEMELUES
HETEM CAKO

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE, GJIROKASTER

Nr. 311 Rep

VERTETIM

Ne Gjirokaster sot me daten 11.02.2000 para meje noteres Greta Kallojeri u paraqit personalisht i quajturi Hetem Cako i biri i Dervishit i Dl. 1968, banues ne Kordhoce, Gjirokaster per te cilin u njojta sipas ligjit dhe deklaroi se nenshkrimi ne kete Statut eshte shprehje e lire e vullnetit te tij.

NOTERE
GRETA KALLOJERI

